UDHËZIM
Nr. 20, datë 10.10.2007

PËR MODELET E LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 2/1, datë 3.3.2008; nr. 6, datë 29.4.2008; nr. 8, datë 23.6.2008; nr. 3, datë 31.1.2012; nr. 5627, datë 18.11.2016; nr. 3919, datë 18.7.2017; nr. 8, 19.12.2019; nr. 8, datë 31.12.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", *ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* dhe udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor",

Me qëllim: njësimin dhe përmirësimin e cilësisë në kontrollin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave që lëshohen në fushën e transportit rrugor, *Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës*,

UDHËZON:

1. Licencat, autorizimet dhe certifikatat për ushtrimin e veprimtarive në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave lëshohen në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Certifikatat për veprimtarinë e transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit me autobus, do të jenë sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Autoritetet kompetente të pushtetit vendor kanë të drejtë të përcaktojnë simbolin e mjetit që vendoset në vendin e caktuar të modelit sipas këtij udhëzimi, si dhe të përdorin letër me elemente sigurie.

3. Modelet janë letër në formatin A4. Numri i modelit sipas tabelës në këtë udhëzim dhe i vendosur në anën e djathtë të modelit nuk duhet të dalë në printim.

4. Karakteristikat kryesore të licencave, autorizimeve dhe certifikatave sipas modeleve të tyre, jepen në tabelën që vijon:

Modeli	Emërtimi	Ngjyra	Stema/Simboli	Shenja të tjera
	1. LICENCA			
101	*Shfuqizuar*			
102	*Shfuqizuar*			
103	*Shfuqizuar*			
104	*Shfuqizuar*			
105	Licencë për transport udhëtarësh me taksi.	Portokalli e lehtë	Inicialet dhe kodi i qarkut	Simboli i taksisë
106	Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit.	Portokalli e lehtë	Simboli i bashkisë/ komunës	Nuk ka
107	*Shfuqizuar*			

108	Licencë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka ose autobus
109	Licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.	E gjelbër	Simboli bashkisë/ k. qarkut	Simboli i kamionit
110	Licencë për transport mallrash me mjete jashtë norme.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka
111	Licencë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira.	Bezhë e lehtë	Stema e Republikës	Simboli i kamionit
112	Licencë për ushtrimin e veprimtarisë të agjencisë spedicionere.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka ose kamion
113	*Shfuqizuar*			
114	*Licencë për kompetencë profesionale në fushën e transportit dhe sigurisë rrugore*	*E bardhë*	*Stema e Republikës*	*Nuk ka*

Modeli	Emërtimi	Ngjyra	Stema/ Simboli	Shenja të tjera
	2. CERTIFIKATA			
201	*Shfuqizuar*			
202	*Shfuqizuar*			
203	*Shfuqizuar*			
204	*Shfuqizuar*			
207	Certifikatë për transport ndërkombëtar udhëtarësh.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
208	Certifikatë për shërbimin në linjë të rregullt në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
208	Certifikatë për shërbimet e rregullta, të specializuara në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
208	Certifikatë për shërbimin vajtje-ardhje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
209	Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.	E bardhë	Simboli i bashkisë/ k. qarkut	Nuk ka simbol
210	Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
211	Certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
212	Certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet.	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka simbol
213	Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit.	Rozë	Stema e Republikës	Simboli i tankerit

214	Certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme.	Rozë	Stema e Republikës	Simboli i tankerit
215	*Certifikatë për transportin e udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit*	*E verdhë*	*Stema e Republikës*	*Simboli i bashkisë ose komunës që e lëshon*

Modeli	EMËRTIMI	NGJYRA	STEMA/ simboli	SHENJA TE TJERA
3. AUTORIZIMI DHE LIBRI I UDHËTIMIT				
301	*Shfuqizuar*			
302	*Shfuqizuar*			
303	Autorizim për shërbimin vajtje-ardhje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus.	Bezhë	Stema e Republikës	
304	*Shfuqizuar*			
305	*Shfuqizuar*			
306	*Shfuqizuar*			

Udhëzimi i Ministrit nr. 370, datë 28.1.2004 "Për modelet e licencave, lejeve, certifikatave dhe autorizimeve për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

Modeli 101

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 102

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 103

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 104

(ndryshuar me udhëzimin nr. 6, datë 29.4.2008; shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

EMËRTIMI I QARKUT

BASHKIA _____

Inicialet e qarkut
dhe kodi _____

Numri i serisë_____

LICENCË

Nr. ____, datë __/__/____

PËR
TRANSPORT UDHËTARËSH ME TAKSI

I LËSHOHET:

Simboli i taksisë	**Personit fizik/ juridik:** _____ **Administratori:** _____ **Me seli në:** _____

Tipi autoveturës: .....

Targa e taksisë: .....

Numri i taksisë: .....

Numri i vendeve: .....

Licenca është e vlefshme nga ___/___/_____deri më datën ___/___/_____

Lëshuar në _____, më _____

_____

Firma dhe vula
e autoritetit kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Licenca është personale e zotëruesit dhe nuk është e transferueshme.

2. Licenca mbahet gjithnjë në kopje origjinale dhe është e pavlefshme kur:

a) nuk shoqërohet me dëshminë e taksistit, aktin e vlerësimin e kushteve në shërbimin taksi;

b) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

c) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:emri i shoqërisë dhe adresa e selisë; nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse; data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

3. Licenca hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

- nuk plotësohen më kërkesat në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar: reputacionin e mirë, kompetencën profesionale, gjendjen e përshtatshme financiare;

- subjekti transportues kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me sigurinë rrugore, gjendjen teknike të automjetit dhe me taksimetër jo gjendje pune, ose me taksimetër jashtë funksionimit, ose vula e të cilit është e prishur, e ndryshuar, e palexueshme;

- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës dhe, ose gjatë ushtrimit të aktivitetit; ose

- shkelen kushtet e vendosura në këtë licencë.

4. Niveli dysheme i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse).

5. Ndalohet shërbimi taksi i udhëtarëve në linjë të rregullt.

6. Në vendqëndrimet e taksive të caktuara nga bashkitë merren udhëtarë vetëm nga taksitë që janë nën juridiksionin e tyre.

7. Autoveturat taksi nuk kanë të drejtë të qëndrojnë, përveç vendqëndrimeve të caktuara nga bashkia, ku ato janë licencuar. Autoveturat taksi të bashkive të tjera vetëm mund të lënë udhëtarë në bashkinë, ku kanë pasur për qëllim destinacionin e shërbimit.

8. Pika e nisjes se autoveturës taksi është brenda juridiksionit të bashkisë, ku autovetura taksi është licencuar.

9. Drejtuesit e autoveturave taksi duhet të zbatojnë rregullat e shërbimit taksi në përputhje me rregulloret e hartuara nga këshilli bashkiak.

10. Licenca duhet t'u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë që kërkohet prej tyre.

11. Kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë territorit të rrethit, ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:

a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;

b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.

Shërbimi taksi jashtë territorit të rrethit, sipas shkronjës "b", kryhet vetëm nëpërmjet agjencive të transportit të udhëtarëve të licencuara. Në këtë rast, autovetura taksi duhet të pajiset me dokumentin e udhëtimit për prenotimin/rezervimin, e plotësuar nga agjencia, dhe udhëtarët të jenë të pajisur me dokumentin e identifikimit, të cilat mbahen gjatë gjithë udhëtimit dhe u paraqiten organeve të kontrollit në rrugë, sa herë që kërkohet prej tyre, për të vërtetuar se shërbimi taksi është duke u kryer me grup të prenotuar ose rezervuar më parë.

Organet e kontrollit në rrugë, pas verifikimit, janë të detyruar të vendosin ne dokumentin e udhëtimit, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit/personave që kanë kryer kontrollin.

12. Nga drejtuesi i autoveturës taksi nuk lejohet përdorimi i dokumentit të udhëtimit të udhëtarëve, përveç atij të miratuar nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në përputhje me udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 "Mbi plotësimin e

disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar.

13. Autovetura taksi është e ndaluar të përdoret për qëllime personale të subjektit.

14. Në rastin kur një person drejton një autoveturë taksi të papajisur me licencë, ose me licencë të vjedhur, ose të falsifikuar, ose me dokumente të udhëtimit të falsifikuara, organet e kontrollit në rrugë marrin licencën dhe mbajtësi i saj dënohet në përputhje me pikën 2 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

15. Cilido që shkel kushtet e vendosura në licencë dënohet në bazë të nenit 8 dhe shkronjave "a" dhe "b" të nenit 68 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar dhe të pikës 3 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

Modeli 106

REPUBLIKA E SHQIPëRISë

Simboli i bashkisë / komunës

BashkiA/Komuna _____

LICENCË

Nr. ____, datë __/__/____

PËR
AGJENCI TRANSPORTI UDHËTARËSH DHE TAKSI BRENDA VENDIT

I LËSHOHET:

Personit fizik/juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Licenca është e vlefshme deri më datën __/__/____

_____

Firma dhe vula
e autoritetit kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjenci udhëtarësh: personat fizikë ose juridikë që iu shërbejnë udhëtarëve dhe bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim, me dhënie informacioni, pajisje me bileta, organizim udhëtimi dhe shërbime të tjera që lidhen me transportin, me qëllim mbërritjen e tyre të sigurt dhe në kohë në destinacionin e kërkuar.

2. Kjo licencë i jep të drejtë mbajtësit të saj të kryejë veprimtarinë e agjencisë së transportit të udhëtarëve, i cili ka për detyrë:

- të kryejë këtë veprimtari kundrejt kontratës së lidhur me shoqëritë e transportit, sipas kërkesave të Kodit Civil për këtë shërbim;
- tërheqjen e biletave të transportit të udhëtarëve dhe të faturave përkatëse nga degët rajonale të tatimeve;
- të afishojë dukshëm në vendqëndrimet e autobusëve linjën, vendin e nisjes dhe mbërritjes së autobusit, oraret përkatëse në nisje dhe mbërritje, si dhe kushtet për transportin e bagazheve;
- të shesë dhe të rezervojë biletat e udhëtarëve, sipas çmimeve të miratuara. Bileta të jetë e vulosur me emërtimin e transportuesit;
- të pajisë me bileta transporti bagazhet e udhëtarëve;
- të mbajë në mënyrë të rregullt të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre dhe të transportuesit të cilit i shërben, të ardhurat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe bagazheve, vëllimin e punës së realizuar gjatë transportimit të udhëtarëve etj.

3. Kjo licencë i jep të drejtën mbajtësit të saj të kryejë edhe shërbimin ndaj udhëtarëve me mjete taksi.

4. Licenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.

5. Licenca është e pavlefshme, kur:

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:

- emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
- nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
- data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

6. Licenca hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

- subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara, si reputacion i mirë, kompetencë profesionale dhe gjendje të përshtatshme financiare;
- provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës;
- shkelen detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër.

Modeli 107

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 8, datë 19.12.2019)

Modeli 108

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 6, datë 29.4.2008)

Modeli 108

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____

LIÇENCË

Nr. ____, datë __/__/____

PËR

AGJENCI TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH

I LËSHOHET:



Personit Juridik:_____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Liçenca është e vlefshme deri më datën __/__/____

_____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. *Agjenci Transporti Ndërkombëtar Udhëtarësh*: personat juridike që iu shërbejnë udhëtarëve dhe bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim, me dhënie informacioni, pajisjeje me bileta, organizim udhëtimi dhe shërbime të tjera që lidhen me transportin, me qëllim mbërritjen e tyre të sigurt dhe në kohë në destinacionin e kërkuar.

2. Kjo licencë i jep të drejtë mbajtësit të saj të kryejë veprimtarinë e agjencisë së transportit të udhëtarëve i cili ka për detyrë:
   - të kryejë këtë veprimtari kundrejt kontratës së lidhur me shoqëritë e transportit sipas kërkesave të kodit civil për këtë shërbim.
   - tërheqjen e biletave të transportit të udhëtarëve dhe të faturave përkatëse nga Degët Rajonale të Tatimeve.
   - të afishojë dukshëm në vendqëndrimet e autobusëve linjën, vendin e nisjes dhe mbërritjes së autobusit, oraret përkatëse në nisje dhe mbërritje si dhe kushtet për transportin e bagazheve.
   - të shes dhe rezervojë biletat e udhëtarëve, sipas çmimeve të miratuara. Bileta të jetë e vulosur me emërtimin e transportuesit.
   - të pajisi me bileta transporti bagazhet e udhëtarëve.
   - të mbajë në mënyrë të rregullt të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre dhe të transportuesit të cilit i shërben, të ardhurat nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe bagazheve, vëllimin e punës së realizuar gjatë transportimit të udhëtarëve, etj.

3. Kjo licencë jep të drejtën edhe për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë për transport të brendshëm udhëtarësh dhe taksi, kur zyra e agjencisë ndodhet në vend të përshtatshëm për kryerjen e këtij lloj shërbimi, të vërtetuar me dokument nga Bashkia/ Komuna përkatëse.

4. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.

5. Liçenca është e pavlefshme kur:

   a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
   b) ne te janë bere te palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
      - *emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;*
      - *nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;*
      - *data e fillimit dhe mbarimit te periudhës se vlefshmërisë;*

6. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
   - subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara si, reputacion i mire, kompetencë profesionale, gjendje te përshtatshme financiare.
   - provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.
   - shkelen detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër.

Modeli 109

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SIMBOLI I BASHKISË /KËSHILLIT TË QARKUT

BASHKIA / KËSHILLI I QARKUT _____

LICENCË
Nr. ____, datë __/__/____

PËR
TRANSPORT MALLRASH PËR TË TRETË DHE ME QIRA BRENDA VENDIT

I LËSHOHET:

Simboli i kamionit

Personit fizik/ juridik:_____

Administratori:

_____

Me seli në:

Kjo licencë është e vlefshme edhe për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të mallrave për llogari të vet brenda vendit.

Licenca është e vlefshme deri më datën __/__/____

_____
Firma dhe vula
e autoritetit kompetent

Modeli 109

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Licenca i jep të drejtën mbajtësit të saj që operon në transportin e mallrave brenda vendit të kryejë:

- transportin e mallrave për të tretë dhe me qira brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

2. Licenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.

3. Licenca është e pavlefshme, kur:

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

b) janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:

- emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
- nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
- data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

4. Licenca hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

- nuk plotësohen më kriteret bazë të licencimit, të përcaktuara sipas nenit 8 të udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007;
- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës.

5. Licenca në origjinal mbahet nga transportuesi. Një kopje e noteruar e licencës duhet të mbahet në bordin e mjetit.

6. Licenca duhet të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e autorizuara të kontrollit.

Modeli 110

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

LIÇENCË

Nr. ____, datë __/__/____

PËR

TRANSPORT TE MALLRAVE ME MJETE JASHTË NORME

I LËSHOHET:

Personit Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Licenca i jep të drejtë mbajtësit të saj të bëjë regjistrimin e mjeteve jashtë norme.

Liçenca është e vlefshme deri më datën ___/___/_____

_____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

Modeli 110

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Liçenca i jep të drejtën mbajtësit të saj të kryejë veprimtarinë e transportit të mallrave me mjete jashtë norme.
2. Konsiderohet jashtë norme mjeti që i kalon, për kërkesa funksionale të veçanta, kufijtë e përmasave gabarite dhe kufijtë e ngarkesave të përcaktuara në nenet 61 dhe 62 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.
3. Licenca i jep të drejtën mbajtësit të saj për të bërë regjistrimin e mjeteve jashtë norme.
4. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
5. Liçenca është e pavlefshme kur:

   a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
   b) janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
      - *emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;*
      - *nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;*
      - *data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;*
6. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
   - Nuk plotësohen më kriteret bazë të liçencimit të përcaktuara sipas nenit 8 të Udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007.
   - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.
7. Liçenca në origjinal mbahet nga transportuesi. Një kopje e noteruar e liçencës duhet të mbahet në bordin e mjetit.
8. Liçenca duhet të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e autorizuar të kontrollit.

Modeli 111

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Republic of Albania
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Ministry of Public Works, Transport and Telecommunications
DREJTORIA E PERGJITHHME E SHERBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR
General Directorate of Road Transport Services

LIÇENCË
LICENCE

Nr. ____, datë __/__/____
No date

PËR

TRANSPORT NDËRKOMBËTAR MALLRASH PËR TË TRETË DHE ME QIRA
(for the international carriage of goods by road for hire or reward)

I LËSHOHET:
ISSUED TO



Personit Fizik/ Juridik:_____
natural/ juridical person:
Administratori: _____
administrator:
Me seli në: _____
trade address

Kjo liçencë lejon edhe ushtrimin e veprimtarisë së transportit të mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit si dhe per transportin e mallrave për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit.

The holder of this licence is allowed to perform road haulage inland transport for hire or reward and on all transports for own account.

Liçenca është e vlefshme deri më datën __/__/____
This license is valid until

_____
Firma dhe Vula
Signature and Stamp
e Autoritetit Kompetent
of the Competent Authority

Modeli 111

DISPOZITA TË PERGJITHSHME
GENERAL PROVISIONS

1. Transportuesi eshte i detyruar te zbatoje, ne territorin e pales tjeter kontraktuese, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative ne fuqi, ne menyre te vecante ato qe lidhen me transportin rrugor dhe qarkullimin.
   (The carrier must, on the territory of the other contracting party, comply with the laws, regulations and administrative measures in force in that State, particularly with regard to transport and traffic).
2. Licenca nuk mund te transferohet nga mbajtesi (titullari) i saj tek një subjekt tjeter.
   (This licence is personal and non-transferable).
3. Licenca eshte e pavlefshme kur *(The Licence is no more longer valid, when)*:
   a) I ka përfunduar afati i vlefshmërisë (*The term of validity is over),*
   b) Ne te mungojnë ose janë bere te palexueshme:
      (In it are either missing or no more legible the following specifications):
      - Emri i shoqërisë *(The name of company)*;
      - Nënshkrimi dhe vula e Autoritetit Kompetent
        (The signature and stamp of the Competent Authority)
      - Data e fillimit dhe mbarimit te periudhës se vlefshmërisë;
        (The starting and the ending date of the validity time period);
4. Licenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
   (The Competent Authority who has issued the License withdraws it, when):
   - Nuk plotesohen më kushtet e vendosuara në Nenin 6 të Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998.
     (No longer meets the conditions laid down in Article 6 of the Law no.8308, date 18.03.1998).
   - Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo te sakte dhe/ose te falsifikuar ne lidhje me te dhënat e kërkuara për marrjen e autorizimit.
     (It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the license).
5. Licenca në original mbahet nga transportuesi. Një kopje e noteruar e licencës duhet të mbahet në bordin e mjetit.
   (The original of the licence must be kept by the haulage undertaking. A certified copy of the license must be kept in the vehicle).
6. Licenca duhet të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e kontrollit.
   (The licence must be produced whenever required by an authorized inspecting officer).
7. Kjo licence duhet te shoqerohet ose jo me leje kalimi bilaterale ose multilaterale, sipas marreveshjeve nderkombetare te transportit rrugor te mallrave.
   (The holder of this licence is obliged to be equipped or not with the bilateral or multilateral permit, under international agreements for carriage of goods by road).

Modeli 112

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

LIÇENCË

Nr. ____, datë __/__/____

PËR

USHTRIMIN E VEPRIMTARISË TE AGJENCISË SPEDICIONERE

I LËSHOHET:



Personit Juridik:_____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Liçenca është e vlefshme deri më datën __/__/____

_____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

Modeli 112

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

1. *Agjenci Spedicionere*: personi juridik ndërmjetës që planifikon dhe organizon transportin e mallrave dhe/ose shërbimet e lidhura me të, në emër të dërguesit të mallit.
2. Licenca nuk mund te transferohet nga mbajtesi (titullari) i saj tek nje subjekt tjeter.
3. Licenca eshte e pavlefshme kur:
   a) i ka perfunduar afati i vlefshmerise,
   b) ne te jane bere te palexueshme ose mungojne specifikimet e meposhteme:
      - *emri i shoqerise dhe adresa e selise;*
      - *nenshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula perkatese;*
      - *data e fillimit dhe mbarimit te periudhes se vlefshmerise;*
4. Licenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka leshuar ate, kur:
   - Subjekti nuk ploteson më kushtet e kerkuara si, reputacion i mire, kompetence profesionale dhe gjendje te pershtatshme financiare.
   - Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo te sakte dhe/ose te fallsifikuar ne lidhje me te dhenat e kerkuara per marrjen e licences.

Modeli 113

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 2/1, datë 3.3.2008; shfuqizuar me udhëzimin nr. 6, datë 29.4.2008)

Modeli 114

(Shtuar me udhëzimin nr. 2/1, datë 3.3.2008; shfuqizuar me udhëzimin nr. 8, datë 23.6.2008)

Modeli 201

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 202

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 203

(Shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 204

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 6, datë 29.4.2008; shfuqizuar me udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016)

Modeli 207

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Republic of Albania

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication

DREJTORIA E LICENCIMIT
Directorate of Licences

CERTIFIKATË
CERTIFICATE
Nr. ____, datë __/__/____
No date
PËR TRANSPORT NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH
(for the international transport of passengers)

I LëSHOHET AUTOBUSIT:
Issued to the bus
Targa: _____
Number plate
Marka: _____
Make/type

Në përdorim të personit juridik: _____
To be used by the juridical person
Sipas licencës Nr. ____, datë __/ __/ ____.
By of the licence No. Datë

Kjo certifikatë është e vlefshme për transporte ndërkombëtare të rastit të udhëtarëve me autobus.
This certificate gives the right to carry out the occasional services in the international transport of passengers by bus.

Kjo Certifikatë është e vlefshme edhe për transporte të brendshme të rastit të udhëtarëve me autobus.
This certificate is also valid for the occasional services in the inland passengers transport.

Certifikata është e vlefshme deri më datën __/__/____
The certificate is valid until

_____
Firma dhe Vula
Signature and Stamp
e autoritetit kompetent
of the Competent Authority

Modeli 207

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
GENERAL PROVISIONS

1. Transportuesi është i detyruar të zbatojë, në territorin e palës tjetër kontraktuese, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me transportin dhe qarkullimin. (The carrier must, on the territory of the other contracting party, comply with the laws, regulations and administrative measures in force in that State, particularly with regard to transport and traffic).

2. Kjo certifikatë është e vlefshme për kryerjen e shërbimeve të rastit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus. (This certificate permits the international carriage of

passengers by bus):

a) me dyer të mbyllura; (Closed-door tours);

b) vajtje me autobus plot dhe kthim bosh; (Services which make the outward journey laden and the return journey unladen);

c) vajtje bosh dhe kthim me autobus plot; (Services during which the outward journey is made unladen and all the passengers are taken up in the same place).

3. Ndalohet transporti i udhëtarëve ndërmjet dy pikave brenda territorit të palës tjetër kontraktuese.

(It is forbidden the carriage of the passengers from a point to another point in the territory of the other contracting party).

4. Certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.

(This certificate is personal and non-transferable).

5. Certifikata është e pavlefshme, kur: (The Certificate is no more longer valid, when):

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë; (The term of validity is over);

b) në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:

(In it are either missing or no more legible the following specifications):

- emri i shoqërisë; (The name of company);
- nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent;

(The signature and stamp of the Competent Authority);

- data e fillimit dhe e mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

(The starting and the ending date of the validity time period).

6. Certifikata hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

(The Competent Authority who has issued the Certificate withdraws it, when):

- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e certifikatës;

